

UDHËZIM
Nr. 26, datë 29.12.2016

PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN
NR. 10, DATË 9.3.2015,
“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR MENAXHIMIN NËPËRMJET FONDIT
KOMBËTAR TË BASHKËFINANCIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR
PROJEKTET IPA”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 11, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)”, të ligjit nr. 37/2015, datë 9.4.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit të Asistencës e Paraanëtarësimit (IPA II)”, VKM nr. 23, datë 12.1.2011, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), Komponenti I: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional”, e ndryshuar, VKM nr. 541, datë 18.6.2015, “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA II”, dhe VKM nr. 966, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPARD II (2014–2020), Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 10, datë 9.3.2015, “Për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet Fondit Kombëtar të Bashkëfinancimit të buxhetit të shtetit për projektet IPA”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

I. Në pikën III “Procedurat për zbatimin”, nënpika III.1, paragrafi i parë, hiqet togfjalëshi “Ministrinë përgjegjëse për investimet publike dhe”.

II. Pika IV, “Procedurat e raportimit”, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë vijon:

“Fondi Kombëtar, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi dhe të udhëzimit të përvitshëm të ministrit të Financave për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin, brenda datës 5 të muajit pasardhës, dërgon raportimin për llogaritë speciale të fondeve të bashkëfinancimit dhe të fondeve të BE-së në Bankën e Shqipërisë, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë integrale e tij.”.

III. Paragrafi V ndryshohet si më poshtë vijon:

“V. Procedura për financim të veçantë

Në rastet kur si pasojë e një vonese procedurale, apo për arsye të tjera objektive, gjendja e fondeve të BE-së në llogaritë e Fondit Kombëtar pranë Bankës së Shqipërisë rezultojnë pamjaftueshme për të respektuar skedulin e paracaktuar të pagesave, Fondi Kombëtar merr masat e

nevojshme për nisjen e procedurave për gjetjen e financimit të veçantë të nevojshëm (*bridge financing*).

Si burim financimi të veçantë për sa më sipër, mund të shërbejnë:

- fondet e programuara si kosto lokale/TVSH për projekte të financuara me fonde IPA, ekzekutimi i të cilave është më i ngadaltë se skeduli i parashikuar;
- shpenzimet korrente të buxhetit vjetor të Ministrisë së Financave;
- fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

Fondi Kombëtar, me aprovimin e ZKA-së, i drejtohet zyrtarisht strukturës përgjegjëse për buxhetin e shtetit në Ministrinë e Financave për identifikimin e burimit të mundshëm për financim dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë pas marrjes së fondeve të vonuara/munguara nga BE-ja, Fondi Kombëtar merr të gjitha masat e nevojshme për kthimin e tyre në buxhetin e shtetit.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj